



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1821 Prot.

Lënda: Konfirmim akti

Elbasan më 11 . 2 . 2026

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.15 datë 30.01.2026 “Miratim shtesë punonjësish për Qendrën e Shërbimeve Të Specializuara KIA GLP Librazhd” si dhe në bazë të të dhënave plotësuese konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA

182

01.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 693 prot

VENDIM

Datë.03.02.2026

Nr.15 dt.30.01.2026

**MIRATIM SHITESË PUNONJËSISH PËR QËNDRËN E SHËRBIMEVE TË
SPECIALIZUARA KIA GLP LIBRAZHD**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “Kreu i IX neni 54 gërma dh, në Shkresën me Nr.Prot.588 datë 29.01.2029 të World Vision Albania “Kërkesë për miratimin e përfshirjes së pozicioneve Psikolog dhe Mësues Mbështetës për Qendrën KIA GLP, për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuar në strukturën e Bashkisë Librazhd “, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Librazhd i mbledhur sot në date 30.01.2026:

V E N D O S I:

1. Shtimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Librazhd me 2 (dy) punonjës.
2. Numri total i punonjësve të Bashkisë për vitin 2026 të jetë 458.
3. Efektet financiare për pagat dhe sigurimet shoqërore do të përballohen nga fondet e Bashkisë.
4. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Buxhetit Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale.
5. Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA



dt. 29.01.2026

Nr Prot 02

Drejtuar: Z. Mariglen Disha, Kryetar i Bashkisë Librazhd

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Lënda: Kërkesë për miratimin e përfshirjes së pozicioneve Psikolog dhe Mësues Mbështetës të Qendres KIA GLP për fëmijë dhe të rinj me aftësi të Kufizuara. në strukturën e Bashkisë Librazhd

Datë: 29 Janar 2026

I nderuar Z. Disha,

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve të Bashkisë Librazhd në fushën e shërbimeve sociale si dhe bazuar në bashkëpunimin e deritanishëm me World Vision Albania për zbatimin e KIA Green Light Project (Kia GLP), paraqesim për shqyrtim dhe miratim kërkesën për mbështetje institucionale, me qëllim garantimin e vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në territorin e bashkisë suaj.

Përmes Grantit KIA u bë e mundur rikonstruktimi i godinës së vjetër- Ish Prokuroria e cila është shndërruar në një qendër multifunkionale model, sipas standarteve ndërkombetare. Përveç investimit infrastrukturor, KIA përmes WVA ka financuar pagën e dy specialistëve Logoped dhe Fizioterapist, nën strukturën e bashkisë nga tetori 2023 deri në shtator 2025.

Prej dy vitesh, në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Librazhd, qendra KIA GLP ka ofruar shërbime të specializuara psiko-sociale, terapeutike dhe edukative për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, si në Qendrën ashtu edhe përmes ekipit lëvizës në zonat rurale. Nga këto shërbime kanë përfituar:

- 104 fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara shërbime në qendër dhe përmes shërbimit lëvizës (Seanca logopedie, fizioterapie, terapi zhvillimi dhe terapi psikologjike)
- 200 prindër janë pajisur me aftësi dhe teknika për zhvillimin e fëmijëve,
- 90 profesionistë psiko-socialë të shkollave, profesionistëve shëndetsorë përmes trajnimeve të ndryshme,
- 1500 të rinj të angazhuar përmes aktiviteteve psiko-sociale, kampe verore, ëorkshope dhe aktivitete ndërgjegjësuese.
- 87 fermerë janë suportuar me fidane arra dhe lajthie me qëllim rritjen e të ardhurave familjare

Gjatë zbatimit të projektit, një rol kyç në ofrimin e shërbimeve me cilësi kanë pasur dy pozicione thelbësore:

- Psikologu i qendrës, dhe
- Koordinator i qendrës / Mësues mbështetës,

të cilët janë mbuluar financiarisht nga World Vision Albania, përkatësisht

- Entela Luadhi - Psikologjia e qendrës deri në dhjetor 2025
- Ermal Tirollari- Koordinator i qendrës/Mësues mbështetës deri në Janar 2026

Duke marrë parasysh:

- rritjen e numrit të fëmijëve që kërkojnë shërbime të specializuara,
- ndikimin e drejtpërdrejtë dhe të matshëm të këtyre shërbimeve në zhvillimin, përfshirjen sociale dhe mirëqenien e fëmijëve,
- përkushtimin e marrë për vazhdimësinë e këtyre shërbimeve si përkundrejt Ministrisë së Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale dhe Donatorit Kia Motors,
- si dhe kufizimet financiare afatgjata të projekteve me financim të jashtëm,

ju parashtrijmë kërkesën për përfshirjen e të dy pozicioneve të sipërpërmendura në strukturën dhe organikën e Bashkisë Librazhd, në mënyrë që:

- të vazhdohet shërbimi psikologjik për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, terapia e zhvillimit, supervizimi klinik i stafeve psiko-sociale në shkolla, mbështetje psikologjike e prindërve përmes aktiviteteve të psiko-edukimit, terapia në grup dhe individuale.
- të vazhdohet organizimi i aktiviteteve ditore, ndërgjegjësuere, në qendër dhe në komunitet në bashkëpunim me aktorët lokalë, koordinimi i marrëdhënieve WVA dhe qendër Kia GLP, mbështetja arsimore dhe psiko-sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta arsimore, përgatitja e fëmijës për integrim në shkollë, asistim në tranzicionin nga qendra → shkollë → komunitet
- të mos cenohet cilësia e shërbimeve ekzistuese,
- të sigurohet vazhdimësia e tyre edhe pas përfundimit të mbështetjes së donatorit,
- dhe të forcohet sistemi lokal i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- të ruhet modeli i ngritur i këtyre shërbimeve si shëmbull për bashkitë e tjera jo vetëm në qarkun e Elbasanit, por dhe me gjerë.

Kjo ndërhyrje do të përfaqësonte një hap konkret drejt qëndrueshmërisë së shërbimeve sociale, në përputhje me përgjegjësitë ligjore të pushtetit vendor dhe me prioritetet kombëtare për përfshirjen sociale dhe arsimin gjithëpërfshirës. Gjithashtu kjo qëndrueshmëri shërbimesh dhe stafi është një angazhim përkundrejt donatorit KIA Motors.

World Vision Albania mbetet i angazhuar për të mbështetur Bashkinë Librazhd në këtë proces tranzicioni, përmes asistencës teknike, ndërtimit të kapaciteteve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm institucional.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen e deritanishme, mbetemi në dispozicion për një takim sqarues dhe për diskutimin e mëtejshëm të kësaj kërkesë.

Me respekt,

Eljona Elmazi
Drejtor Ekzekutiv
World Vision Albania

